



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 175

Tiranë – E martë, 11 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10984, datë 27.11.2018	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 12135
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 834, datë 3.12.2018	Për hyrjen në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë në aeroportet e Republikës së Shqipërisë..... 12135
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 646, datë 6.12.2018	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme..... 12143
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Thoma Lashi..... 12146

**DEKRET****Nr. 10984, datë 27.11.2018****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Melissa Jahjush Rama (Kupina)
2. Albert Jan Prifti
3. Maria Albert Prifti
4. Shpresa Zoi Prifti (Toli)
5. Sajad Behar Sadik
6. Ervin Ferzi Hoxhallari
7. Valmira Rifat Murosky (Rama)
8. Klodian Qazim Hoxha
9. Ilirjan Ramis Arbri
10. Erlin Ilirjan Arbri
11. Jona Ilirjan Arbri
12. Zorica Velo Matanoviq (Kontiq)
13. Milko Urosh Krstović
14. Andi Vasillaq Tego
15. Shqipe Muhamet Maikler (Hada)
16. Mateos Dashamir Neviri
17. Merita Sulo Deskaj (Shpuza)
18. Erjola Guri Gori (Goxha)
19. Arel Arian Hetaj
20. Giselda Rexhep Elezaj
21. Dritan Miti Muçaraku
22. Fatbardha Miftar Gabraj (Nezaj)
23. Brikena Mahil Lalazi (Telharaj)
24. Selida Sezai Dani
25. Fabian Stavri Buli
26. Fatmir Faik Boja
27. Delina Novruz (Novrus) Binaj
28. Agustin Ali Cani
29. Besa Fatos Jazxhi
30. Noel Martin Bejleri
31. Eni Çlirim Huta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM¹**Nr. 834, datë 3.12.2018****PËR HYRJEN NË TREGUN E
SHËRBIMEVE TË PËRPUNIMIT NË
TOKË NË AEROPORTET E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 73, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky udhëzim zbatohet në çdo aeroport që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, që i nënshtrohet legjislacionit shqiptar përfshirë Marrëveshjen Shumëpalëshe dhe është i hapur për trafikun tregtar në rrethanat e mëposhtme:

a) Dispozitat e nenit 7(1) lidhur me kategoritë për shërbimet e përpunimit në tokë të listuara në shtojcën e këtij udhëzimi, përveç atyre që parashikohen në nenin 7(2), do të zbatohen në çdo aeroport pavarësisht nga volumi i tij i trafikut.

¹ Ky udhëzim është përafuar pjesërisht me: direktivën e Këshillit nr. 96/67/EC e 15 tetor 1996 mbi hyrjen në tregun e përpunimit në tokë në aeroportet e Komunitetit, e ndryshuar me Rregulloren (EC) nr. 1882/2003, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 shtator 2003.



b) Dispozitat lidhur me kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë që jepen në nenin 7(2) do të zbatohen për aeroportet, volumi vjetor i trafikut të të cilëve është me një lëvizje jo më pak se 1 milion pasagjerë ose 25000 tonë mallra.

c) Parashikimet lidhur me kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë të përcaktuara në nenin 6 do të zbatohen për aeroportet:

- Trafiku vjetor i të cilëve nuk është më pak se 3 milionë lëvizje pasagjerësh ose 75000 tonë mallra; ose

- Trafiku i të cilëve nuk ka qenë më pak se 2 milionë lëvizje pasagjerësh ose 50000 tonë mallra gjatë periudhës 6-mujore të vitit paraardhës nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

2. Pa rënë në kundërshtim me paragrafin 1, dispozitat e këtij udhëzimi që lidhen me kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë të përcaktuara në nenin 6 do të zbatohen në çdo aeroport që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, që është subjekt i legjislacionit shqiptar në fuqi, përfshirë dhe Marrëveshjen Shumëpalëshe, i cili është i hapur për trafikun tregtar, trafiku vjetor i të cilit është me një lëvizje jo më të vogël se 2 milionë pasagjerë ose 50000 tonë mallra.

3. Kur një aeroport arrin një nga pragjet e trafikut të mallrave të përmendura në këtë nen, pa arritur pragun përkatës të lëvizjes së pasagjerëve, dispozitat e këtij udhëzimi nuk do të zbatohen për kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë të rezervuara në mënyrë ekskluzive për pasagjerët.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil merr masa për publikimin, të një liste të aeroporteve që referohen në këtë nen, për të cilën informon edhe strukturën e Komitetit të Përbashkët, siç përcaktohet në Marrëveshjen Shumëpalëshe. Lista do të publikohet fillimisht brenda tre muajve mbas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, dhe në vijim për çdo vit. Përpara 1 korrikut të çdo viti, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i dërgojë ministrit dhe strukturës së Komitetit të Përbashkët, siç përcaktohet në Marrëveshjen Shumëpalëshe, të dhënat që nevojiten për hartimin e listës.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij udhëzimi, përkufizimet dhe shkurtimeve kanë kuptimet si më poshtë:

a) “AAC” nënkupton Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë;

b) “Aeroport” nënkupton çdo zonë të tokës, e përshtatur në mënyrë të veçantë për uljen, ngritjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve, duke përfshirë instalimet ndihmëse që mund të kërkojnë këto operime për kërkesat e trafikut dhe shërbimeve të avionëve, duke përfshirë instalimet që nevojiten për të asistuar shërbimet ajrore tregtare;

c) “Enti menaxhues i aeroportit” nënkupton një organ, i cili së bashku me aktivitetet e tjera apo jo sipas rastit, ka si objektiv, në përputhje me ligjet dhe rregullat e Republikës së Shqipërisë, administrimin dhe drejtimin e infrastrukturës së aeroportit, si dhe koordinimin e kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm që janë prezent në aeroport apo në sistemin e aeroporteve në fjalë;

d) “Marrëveshje shumëpalëshe” është marrëveshja shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, shtojcat dhe Protokolli I i saj, për krijimin e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në vijim referuar si marrëveshja shumëpalëshe;

e) “Ministri” nënkupton ministrin përgjegjës për transportin;

f) “Ofruesi i shërbimeve të përpunimit në tokë” nënkupton çdo person fizik ose juridik që kryen për palë të treta një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë;

g) “Përdoruesi i aeroportit” nënkupton çdo person fizik ose juridik përgjegjës për transportin ajror të pasagjerëve, postës dhe/ose mallrave nga, ose për në aeroportin në fjalë;

h) “Përpunimi në tokë” nënkupton shërbimet që i jepen përdoruesve të aeroportit në aeroportet siç përshkruhen në shtojcën e këtij udhëzimi;

i) “Sistemi i aeroporteve” nënkupton dy ose më shumë aeroporte të grupuara së bashku për t'i shërbyer të njëjtit qytet ose zonë urbane, siç përcaktohet në legjislacionin mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore;



j) “Vetëpërpunim” nënkupton një situatë në të cilën një përdorues aeroporti kryen direkt për veten e tij një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë dhe nuk lidh asnjë lloj kontrate me një palë të tretë për kryerjen e këtyre shërbimeve; për qëllime të këtij përcaktimi, përdoruesit e aeroportit nuk janë palë të treta, kur:

- njëri zotëron shumicën e aksioneve të tjetrit; ose
- një organ i vetëm ka shumicën e aksioneve të secili.

Neni 3

Enti menaxhues i aeroportit

1. Kur një aeroport ose sistem aeroportesh menaxhohet dhe operohet jo nga një ent i vetëm, por nga disa ente të veçanta, secili nga këto ente do të konsiderohet si pjesë e entit menaxhues të një aeroporti për qëllime të këtij udhëzimi.

2. Në mënyrë të ngjashme, atje ku është ngritur vetëm një ent menaxhues për disa aeroporte apo sistem aeroportesh, secili nga ata aeroporte apo sistem aeroportesh do të konsiderohet i veçantë për qëllim të këtij udhëzimi.

3. Autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë, si AAC-ja, por jo vetëm, të cilat kanë detyrimet ligjore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e enteve menaxhuese të aeroportëve, janë të detyruar të garantojnë zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 4

Ndarja e llogarive

1. Kur enti menaxhues i një aeroporti, përdoruesit e aeroportit ose ofruesit e shërbimeve në tokë ofrojnë shërbime të përpunimit në tokë, ata duhet të ndajnë në mënyrë rigoroze llogaritë e aktiviteteve të tyre të shërbimit në tokë, nga llogaritë e aktiviteteve të tjera të tyre, në përputhje me praktikat tregtare në fuqi.

2. Ndarja e llogarive të përmendura në pikën 1 të këtij neni, duhet të kontrollohet nga një auditues i pavarur i certifikuar, i cili duhet të pasqyrojë në raportin financiar vjetor të tij, nëse kjo ndarje është kryer, si dhe në rastin kur enti menaxhues i aeroportit ofron edhe shërbime të përpunimit në tokë, në raportin financiar duhet të pasqyrohet se nuk ka lëvizje financiare ndërmjet aktiviteteve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe funksioneve të tjera të tij.

3. Raporti i audituesit sipas pikës 2 do të paraqitet AAC-së jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit financiar të mëparshëm.

Neni 5

Komiteti i përdoruesve të aeroportit

1. AAC-ja do të garantojë, për çdo aeroport që ka lidhje me këtë udhëzim, që është krijuar një komitet i përfaqësuesve të përdoruesve të aeroportit ose të organizatave që përfaqësojnë përdoruesit e aeroportit.

2. Të gjithë përdoruesit e aeroportit do të kenë të drejtë të jenë në këtë komitet, ose nëse dëshirojnë do të përfaqësohen në të nga një organizatë e caktuar për këtë qëllim.

Neni 6

Shërbimet në tokë për palët e treta

1. AAC-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për të garantuar hyrje të lirë në treg nga ofruesit e shërbimeve në tokë për kryerjen e shërbimeve të përpunimit në tokë për palët e treta.

AAC-ja ka të drejtë të kërkojë që ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë të jenë të themeluar në Republikën e Shqipërisë ose brenda Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

2. AAC-ja mund të kufizojë numrin e ofruesve të miratuar në një aeroport për të ofruar kategoritë e mëposhtme të shërbimeve të përpunimit në tokë:

- përpunimi i bagazheve;
- përpunimi në vendqëndrimin e avionëve;
- furnizimi me karburant dhe me vajra lubrifikante;
- përpunimi i mallrave dhe postës për sa i përket përpunimit fizik të mallrave dhe postës qoftë në ardhje, në largim ose që janë transferuar ndërmjet terminalit dhe avionit.

Ky kufizim nuk mund të bëhet në më pak se dy ofrues për çdo kategori të shërbimit.

3. Të paktën një nga ofruesit e autorizuar nuk mund të kontrollohet drejtpërdrejt ose indirekt nga:

- enti menaxhues i aeroportit;
- përdoruesi i aeroportit që ka transportuar më shumë se 25% të pasagjerëve ose mallrave të regjistruar në aeroport gjatë vitit paraardhës të atij viti gjatë të cilit ata ofrues u përzgjedhën;



- një ent që kontrollon ose është i kontrolluar drejtpërdrejt ose indirekt nga ai ent manaxhues ose çdo përdorues i tillë.

4. Aty ku, në përputhje me paragrafin 2, kufizohet numri i ofruesve të autorizuar, AAC-ja nuk mund të ndalojë një përdorues aeroporti, pavarësisht nga pjesa që i është alokuar atij, për të pasur, për çdo kategori të shërbimeve në tokë, subjekt kufizimi, pasjen e një zgjedhjeje efektive mes 2 ofruesve të fundit, sipas kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3.

Neni 7

Shërbimi i vetëpërpunimit në tokë

1. AAC-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 1, për të siguruar lirinë e shërbimit të vetëpërpunimit në tokë.

2. Gjithsesi për kategoritë e mëposhtme të shërbimeve në tokë, AAC-ja duke marrë parasysh edhe mendimin e entit menaxhues të një aeroporti mund t'i rezervojë të drejtën për vetëshërbim jo më pak se dy përdoruesve të aeroportit me kusht që ata të jenë përzgjedhur mbi bazë të kriterëve përkatëse, objektive, transparente dhe jodiskriminuese. Kategoritë subjekt i këtij parashikimi, janë:

- përpunimi i bagazheve;
- përpunimi në vendqëndrimin e avionëve;
- furnizimit me karburant dhe me vajra lubrifikante;
- përpunimi i mallrave dhe postës për sa i përket përpunimit fizik të mallrave dhe postës qoftë në ardhje, në largim ose që janë transferuar ndërmjet terminalit dhe avionit.

Neni 8

Infrastrukturat e centralizuara

1. Pavarësisht zbatimit të neneve 6 dhe 7, AAC-ja, në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit, mund të rezervojë për entin menaxhues të aeroportit ose për ndonjë ent tjetër drejtimin e infrastrukturave të centralizuara të përdorura për realizimin e shërbimeve të përpunimit në tokë, kompleksiteti, kostoja apo ndikimi mjedisor i të cilave nuk lejon ndarjen apo dyfishimin e tyre, siç mund të jenë ndarja e bagazheve, heqja e akullit, pastrimi i ujit dhe sistemet e shpërndarjes së karburantit. Ata mund të bëjnë të detyrueshme që ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë dhe përdoruesve të aeroportit që kryejnë vetëpërpunim të përdorin këto infrastrukture.

2. AAC-ja do të sigurojë që menaxhimi i këtyre infrastrukturave të jetë transparent, objektiv dhe jodiskriminues dhe, në veçanti, që kjo nuk do të pengojë afrimin e furnizuesve të shërbimeve të përpunimit në tokë apo vetëpërpunimit të përdoruesve të aeroportit brenda kufijve të përcaktuar në këtë udhëzim.

Neni 9

Përfashtimet

1. Kur në një aeroport shfaqen vështirësi për hapësirën dhe kapacitetin, që rezultojnë, veçanërisht, si rezultat i mbingarkesës dhe tejkallimit të normës së shfrytëzimit të zonës, të cilat e bëjnë të pamundur lirinë e tregut të shërbimeve dhe/ose zbatimit të vetëpërpunimit në shkallën e përcaktuar në këtë udhëzim, me kërkesë të entit menaxhues të aeroportit, AAC-ja, në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit, mund të vendosë:

a) Të kufizojë numrin e ofruesve për një ose më shumë kategori të shërbimeve të përpunimit në tokë, përveç atyre të parashikuara në nenin 6(2), në të gjithë aeroportin apo në pjesë të tij. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e neneve 6(2) dhe 6(3);

b) T'i rezervojë një ofruesi të vetëm një ose më shumë kategori të shërbimeve të përpunimit në tokë të referuara në nenin 6(2);

c) Të rezervojë vetëpërpunimin në një numër të kufizuar të përdoruesve të aeroportit për kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë, përveç atyre të referuara në nenin 7(2), me kusht që këta përdorues të jenë zgjedhur mbi bazën e kriterëve përkatëse, objektive, transparente dhe jodiskriminuese;

d) Të ndalojë vetëpërpunimin në tokë ose ta kufizojë atë në një përdorues të vetëm të aeroportit për kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë të përcaktuara në nenin 7(2).

2. Të gjitha përfashtimet e vendosura në pikën 1, të këtij neni, duhet:

a) Të specifikojnë kategorinë ose kategoritë e shërbimeve të përpunimit në tokë për të cilat është dhënë përfashtimi dhe kufizimet specifike të hapësirës ose të kapacitetit të vlefshëm që e justifikojnë atë;

b) Të jenë të shoqëruara nga një plan masash përkatëse për të kapërcyer këto kufizime.

Për më tepër, përfashtimet nuk duhet:



i. të paragjykojnë pa arsye qëllimet e këtij udhëzimi;

ii. të cenojnë konkurrencën e lirë ndërmjet furnizuesve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe/ose vetëpërpunimit nga përdoruesit e aeroportit;

iii. të shtrihen më tej se sa është e nevojshme.

3. AAC-ja njofton ministrin, të paktën 3 muaj përpara hyrjes në fuqi të çdo përjashtimi të dhënë bazuar në pikën 1, të këtij neni, si dhe bazën mbi të cilën këto përjashtime janë bërë.

4. Vendimet e mara nga AAC-ja për përjashtimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shqyrtohen nga ministri. Për këtë qëllim, do të bëhet një analizë e detajuar e situatës dhe një studim i masave të përshtatshme të paraqitur nga AAC-ja për të parë se kufizimet e pretenduara ekzistojnë dhe se është e pamundur për të zgjeruar tregun dhe/ose për të vënë në zbatim vetëpërpunimin në masën e përcaktuar nga ky udhëzim.

5. Pas marrjes në shqyrtim, ministri mund të miratojë përjashtimin ose ta kundërshtojë atë nëse konsideron se kufizimet e pretenduara nuk janë provuar që ekzistojnë ose nuk janë aq të rënda sa për të justifikuar përjashtimin. Pas konsultimit me AAC-në, ministri mund t'i kërkojë AAC-së të ndryshojë shkallën e përjashtimit ose ta kufizojë atë në ato pjesë të sistemit të aeroportit, ku kufizimet e pretenduara janë provuar që ekzistojnë.

6. Vendimi i ministrit do të merret jo më vonë se 3 muaj pas njoftimit të përjashtimit të dorëzuar nga AAC-ja.

7. Përjashtimet e bëra nga AAC-ja në përputhje me pikën 1, të këtij neni, nuk mund të kalojnë një kohëzgjatje prej më shumë se tre vjetësh, përveç përjashtimeve të dhëna sipas pikës 1(b). Jo më vonë se tre muaj para përfundimit të kësaj periudhe, AAC-ja duhet të marrë një vendim të ri për çdo kërkesë për përjashtim, i cili, gjithashtu, do t'i nënshtrohet procedurës së përcaktuar në këtë nen.

8. Komisioni Evropian do të njoftohet për përjashtimet e realizuara, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

Neni 10

Përzgjedhja e ofruesve

1. AAC-ja duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin e procedurës së përzgjedhjes së ofruesve që do të autorizohen për kryerjen e shërbimeve të përpunimit në tokë në një aeroport ku numri i tyre është i kufizuar sipas rasteve të parashikuara në nenin 6(2), ose në nenin 9.

Procedura e përzgjedhjes duhet të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) Në rastet kur kërkohet krijimi e kushteve standarde ose specifikimet teknike që duhen plotësuar nga ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë, këto kushte ose specifikime do të vendosen pas konsultimeve me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit. Kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara në kushtet standarde ose specifikimet teknike, duhet të jenë të përshtatshme, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Pasi ka njoftuar ministrin, AAC-ja mund të përfshijë përveç kushteve standarde ose specifikimeve teknike, të cilat ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë duhet t'i plotësojnë edhe një detyrim të shërbimit publik në lidhje me aeroportet që u shërbejnë rajoneve periferike ose në zhvillim dhe që janë pjesë e territorit të saj, të cilat nuk kanë interes tregtar, por janë të një rëndësie jetike.

b) Një njoftim për tender duhet të përgatitet dhe të publikohet në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar, të cilit mund t'i përgjigjet çdo ofrues shërbimi i interesuar.

c) Ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë, do të përzgjidhen:

i. nga enti menaxhues i aeroportit pas konsultimit me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit, kur enti menaxhues i aeroportit:

- nuk kryen shërbime të njëjta të përpunimit në tokë; dhe

- nuk ka kontroll direkt apo indirekt mbi ndonjë sipërmarrje që kryen shërbime të tilla; dhe

- nuk ka përfshirje në ndonjë nga këto sipërmarrje;

ii. në të gjitha rastet e tjera, nga AAC-ja, pas konsultimit me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit dhe entin respektiv menaxhues të aeroportit.



d) Ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë do të zgjidhen për një periudhë deri në shtatë vjet.

e) Në rastet kur një ofrues i shërbimeve të përpunimit në tokë ndërpret aktivitetin e tij përpara mbarimit të periudhës për të cilën ai ishte përzgjedhur, ai do të zëvendësohet në bazë të së njëjtës procedurë.

2. Kur numri i ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë është i kufizuar në përputhje me nenin 6(2) ose nenin 9, enti menaxhues i aeroportit mund të kryejë vetë shërbimet e përpunimit në tokë pa qenë subjekt i procedurës së përzgjedhjes të përcaktuar në këtë nen. Në mënyrë të ngjashme, enti menaxhues i një aeroporti mund që, pa e paraqitur atë në procedurën e mësipërme, të autorizojë një sipërmarrje për të kryer shërbimet e përpunimit në tokë në atë aeroport, në rast se:

- ai kontrollon direkt ose indirekt atë sipërmarrje; ose
- sipërmarrja kontrollon direkt ose indirekt aeroportin.

3. Enti menaxhues i një aeroportit do të njoftojë Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit për vendimet e marra në përputhje me këtë nen.

4. Në lidhje me zbatimin e këtij neni, do të kryhen të gjitha komunikimet e nevojshme, siç përcaktohet në Marrëveshjen Shumëpalëshe.

Neni 11

Aeroportet në ishull

Në kuadër të përzgjedhjes së ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë, në aeroport siç përcaktohet në nenin 10, detyrimi për shërbimin publik mund të shtrihet edhe në aeroporte të tjera, me kusht që:

- këto aeroporte janë të vendosura në një ishull në të njëjtën zonë gjeografike; dhe
- kjo shtrirje miratohet nga ministri dhe Komisioni, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

Neni 12

Konsultimet

AAC-ja do të verifikojë se është organizuar një procedurë konsultimi detyruese lidhur me zbatimin e këtij udhëzimi ndërmjet entit menaxhues të aeroportit, Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit dhe sipërmarrjes që

kryen shërbimet e përpunimit në tokë. Ky konsultim do të mbulojë, ndër të tjera, çmimin e atyre shërbimeve të përpunimit në tokë për të cilat është dhënë përjashtim sipas nenit 9(1)(b). Ky konsultim do të organizohet të paktën një herë në vit.

Neni 13

Miratimi

1. AAC-ja mund të bëjë miratimin e aktivitetit të përpunimit në tokë të një ofruesi të këtij shërbimi ose të përdoruesit të vetëshërbimit në një aeroport në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ajo.

Kriteret për një miratim të tillë duhet të lidhen me një situatë të shëndoshë financiare dhe me mbulim të mjaftueshme të sigurimit, për sigurinë e instalimeve, të avionëve, të pajisjeve dhe të personave, si dhe për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me legjislacionin përkatës.

Kriteret duhet të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:

i. ato duhet të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese ndaj ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe përdoruesve të aeroportit;

ii. duhet të lidhen me objektivin e synuar;

iii. nuk mundet që, në praktikë, të zvogëlojnë hyrjen në treg apo lirinë për vetëpërpunim në një nivel nën atë të parashikuar nga ky udhëzim.

Këto kriteret do të bëhen publike dhe ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë, si dhe përdoruesit e vetëtrajtimit të aeroportit duhet të informohen paraprakisht lidhur me procedurën e marrjes së miratimit.

2. Miratimi mund të refuzohet ose të tërhiqet vetëm në qoftë se ofruesi i shërbimeve të përpunimit në tokë apo përdoruesi i vetëpërpunimit në aeroport nuk i përmbush, për arsye të tij, kriteret e përmendura në pikën 1, të këtij neni. Kushtet për mbajtjen apo heqjen e miratimit do t'i komunikohen ofruesit apo përdoruesit të interesuar dhe entit menaxhues të aeroportit.

Neni 14

Rregullat e administrimit

AAC-ja mund që, atje ku është e përshtatshme, sipas një propozimi nga enti menaxhues i aeroportit:



- të ndalojë një ofrues të shërbimeve të përpunimit në tokë ose një përdorues aeroporti nga kryerja e shërbimeve të përpunimit në tokë ose të vetëshërbimit, nëse ky ofrues apo përdorues nuk plotëson rregullat e vendosura kundrejt tij për të garantuar funksionimin e rregullt të aeroportit.

Këto rregulla duhet të përputhen me parimet e mëposhtme:

a) Ato duhet të aplikohen në mënyrë jodiskriminuese për ofruesit e ndryshëm të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe përdoruesit e aeroportit;

b) Ato duhet të lidhen me objektivin e synuar;

c) Praktikisht, ato nuk mund të reduktojnë hyrjen në treg apo lirinë për kryerjen e vetëpërpunimit në tokë në një nivel më të ulët se sa ai i parashikuar në këtë udhëzim;

- në mënyrë të veçantë kërkon që ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë në një aeroport të marrin pjesë në një mënyrë të ndershme dhe jodiskriminuese në kryerjen e detyrimeve të shërbimit publik të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë detyrimin për të garantuar shërbim të pandërprerë.

Neni 15

Hyrja tek instalimet

1. AAC-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë dhe përdoruesit e aeroportit që duan të kryejnë vetëpërpunim do të kenë qasje në instalimet e aeroportit në atë masë që është e nevojshme për të kryer aktivitetin e tyre. Nëse enti menaxhues i aeroportit ose, atje ku është e përshtatshme, autoriteti publik apo ndonjë organ tjetër që e kontrollon atë vendos kushte për këtë qasje, këto kushte duhet të jenë të përshtatshme, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

2. Hapësira në dispozicion për përpunimin në tokë në një aeroport duhet të ndahet ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe përdoruesve të aeroportit që kryejnë vetëpërpunime, duke përfshirë subjektet e reja që kanë hyrë në këtë fushë, në atë masë, që është e domosdoshme për të ushtruar të drejtat e tyre dhe të lejojnë konkurrencën e ndershme dhe efektive, mbi bazën e rregullave

dhe kriterëve përkatëse, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

3. Atje ku qasja në instalimet e aeroportit argumenton mbledhjen e një tarife, kjo duhet të miratohet nga AAC-ja në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit.

Neni 16

Siguria në operim dhe siguria nga ndërhyrjet e paligjshme

Dispozitat e këtij udhëzimi nuk ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet që lidhen me ligjin dhe rendin, sigurinë në operim dhe sigurinë nga ndërhyrjet e paligjshme të aeroportëve.

Neni 17

Mbrojtja sociale dhe mjedisore

Pa rënë ndesh me zbatimin e këtij udhëzimi, dhe në bazë të dispozitave të tjera të Marrëveshjes Shumëpalëshe, autoritetet përkatëse në Republikën e Shqipërisë mund të ndërmarrin masat e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të punonjësve dhe respektimin e mjedisit.

Neni 18

Pajtueshmëria me legjislacionin

Një ofrues i shërbimit të përpunimit në tokë i kërkohet të përmbushë dispozitat e ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe legjislacionin ndërkombëtar përkatës.

Neni 19

Reciprociteti

1. Pa rënë ndesh me angazhimet ndërkombëtare që burojnë nga Marrëveshja e ZPEA-së, kudo ku rezulton që një vend i tretë, lidhur me qasjen në tregun e përpunimit në tokë ose të vetëpërpunimit:

a) Nuk i jep ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe vetëpërpunimit të përdoruesve të aeroportit nga Republika e Shqipërisë, *de jure* ose *de facto*, trajtim të njëjtë me atë që Republika e Shqipërisë i jep ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe vetëpërpunimit të përdoruesve të aeroportit nga ai vend; ose



b) Nuk u jep ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe vetëpërpunimit të përdoruesve të aeroportit nga Republika e Shqipërisë, de jure ose de facto, trajtimin kombëtar; ose

c) U jep ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe vetëpërpunuesve të përdoruesve të aeroportit nga vendet e treta trajtim më të favorshëm se ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe vetëpërpunuesve të përdoruesve të aeroportit nga Republika e Shqipërisë.

AAC-ja mund të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet që rrjedhin nga ky udhëzim në lidhje me ofruesit e shërbimeve të përpunimit në tokë dhe përdoruesve të aeroportit nga ai vend i tretë, në përputhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe.

2. AAC-ja do të njoftojë ministrin për çdo heqje ose pezullim të të drejtave ose detyrimeve të ndërmarra sipas këtij neni.

Neni 20

E drejta e ankimimit

AAC-ja, ose kur është e përshtatshme enti menaxhues i një aeroporti, duhet të sigurojë që çdo palë që ka interes të legjitimuar, të ketë të drejtën e ankimimit kundër vendimeve ose masave individuale të marra në bazë të nenit 7(2) dhe neneve 10 deri 15, të këtij udhëzimi. Në rast të një ankimimi kundër një vendimi të marrë në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi, zbatohen rregullat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Neni 21

Raportimi

AAC-ja do t'i japë ministrit, informacionin e kërkuar nga ai për të hartuar një raport lidhur me zbatimin e këtij udhëzimi. Raporti do të shoqërohet me çdo propozim për rishikimin e tij.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri

SHTOJCË

LISTA E SHËRBIMEVE TË PËRPUNIMIT NË TOKË

1. Administrimi dhe mbikëqyrja në tokë përfshin:

1.1 Shërbimet e përfaqësimit dhe ndërldhjes me autoritetet lokale ose ente të tjera, pagesat në emër të përdoruesit të aeroportit dhe ofrimin të hapësirës së zyrës për përfaqësuesit e saj;

1.2 Kontrollin e ngarkesës, mesazhet dhe telekomunikacionet;

1.3 Përpunimin, ruajtjen dhe administrimin e pajisjeve të ngarkesës për njësi (ULD);

1.4 Çdo shërbim tjetër mbikëqyrje para, gjatë ose pas fluturimit dhe çdo shërbim tjetër administrativ të kërkuar nga përdoruesit e aeroportit.

2. Përpunimi i pasagjerëve përfshin çdo lloj ndihme në: mbërritje, nisje, transferim ose transit të pasagjerëve, duke përfshirë kontrollin e biletave dhe dokumenteve të udhëtimit, regjistrimin e bagazhit dhe transportin e tij në zonën e klasifikimit.

3. Përpunimi i bagazhit përfshin trajtimin e bagazhit në zonën e klasifikimit, ndarjen e tij, përgatitjen e tij për nisje, ngarkimin dhe shkarkimin e tij në/nga pajisjet e caktuara për ta lëvizur atë nga avioni në zonën e klasifikimit dhe anasjellas, si dhe transportin e bagazhit nga zona e klasifikimit në zonën e kërkuar.

4. Përpunimi i mallrave dhe postës, përfshin:

4.1 për mallrat: përpunimin fizik për eksportin, transferimin dhe importimin e mallrave, përpunimin e dokumenteve perkatëse, procedurave doganore dhe zbatimin e çdo procedure të sigurisë së rënë dakord ndërmjet palëve ose të kërkuara nga rrethanat;

4.2 për postën: përpunimin fizik të postës në ardhje dhe në largim, përpunimin e dokumenteve perkatëse dhe zbatimin e çdo procedure të sigurisë të rënë dakord ndërmjet palëve ose të kërkuara nga rrethanat.

5. Përpunimi në vend qëndrimin e avionëve (rampë), përfshin:

5.1 Drejtimin nga marshalli i avionit në tokë në mbërritje dhe në nisje;

5.2 Ndihma në parkimin e avionit dhe sigurimi i pajisjeve të përshtatshme;



5.3 Komunikimi ndërmjet avionit dhe ofruesit të shërbimeve të përpunimit në tokë në zonën ajrore;

5.4 Ngarkimin dhe shkarkimin e avionit, duke përfshirë sigurimin dhe funksionimin e mjeteve të përshtatshme, si dhe transportin e ekuipazhit dhe të pasagjerëve ndërmjet avionit dhe terminalit, dhe transportin e bagazheve ndërmjet avionit dhe terminalit;

5.5 Sigurimin dhe funksionimin e njësive të përshtatshme për lëshimin e motorëve;

5.6 Lëvizjen e avionit në mbërritje dhe nisje, si dhe sigurimin dhe funksionimin e pajisjeve të përshtatshme;

5.7 Transportin, ngarkimi në të dhe shkarkimin nga avioni të ushqimeve dhe pijeve.

6. Shërbimet e avionit përfshijnë:

6.1 Pastrimin e jashtëm dhe të brendshëm të avionit, dhe shërbimet e tualetit dhe të ujit;

6.2 Ftohjen dhe ngrohjen e kabinës, heqjen e borës dhe akullit, çakullzimin e avionit;

6.3 Rirregullimin e kabinës me pajisje të përshtatshme të kabinës, ruajtjen e këtyre pajisjeve.

7. Furnizimi me karburant dhe vaj, përfshin:

7.1 Organizimin dhe kryerjen e operimeve të furnizimit me karburant dhe heqjen e karburantit, duke përfshirë ruajtjen e karburantit dhe kontrollin e cilësisë dhe sasisë së dërgesave të karburantit;

7.2 Plotësimin me vaj dhe lëngje të tjera.

8. Mirëmbajtja e avionit përfshin:

8.1 Shërbimet e zakonshme që kryhen para fluturimit;

8.2 Shërbimet jo të zakonshme të kërkuara nga përdoruesi i aeroportit;

8.3 Sigurimi dhe administrimi i pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve të përshtatshme;

8.4 Kërkesa për/ose rezervimi i një parkingu të përshtatshëm dhe/ose hapësire në hangar.

9. Operimet e fluturimit dhe administrimi i ekuipazhit, përfshijnë:

9.1 Përgatitjen e fluturimit në aeroportin e nisjes ose në ndonjë pikë tjetër;

9.2 Ndihma në fluturim, përfshirë rinisjen nëse është e nevojshme;

9.3 Aktivitetet mbas fluturimit;

9.4 Administrimi i ekuipazhit.

10. Transporti tokësor, përfshin:

10.1 Organizimin dhe kryerjen e transportit të ekuipazhit, pasagjerëve, bagazhit, mallrave dhe të postës ndërmjet terminaleve të ndryshme të të

njëtit aeroportit, por duke përjashtuar të njëjtin transport ndërmjet avionit dhe çdo pike tjetër brenda perimetrit të aeroportit të të njëjtit aeroport;

10.2 Çdo transport të veçantë të kërkuar nga përdoruesit e aeroportit.

11. Shërbimet e furnizimit me ushqime (*catering*), përfshijnë:

11.1 Lidhjen me furnizuesit dhe menaxhimin administrativ;

11.2 Ruajtjen e ushqimeve dhe pijeve dhe të pajisjeve të nevojshme për përgatitjen e tyre;

11.3 Pastrimin e këtyre pajisjeve;

11.4 Përgatitjen dhe shpërndarjen e pajisjeve, si dhe të pijeve dhe furnizimeve ushqimore.

URDHËR

Nr. 646, datë 6.12.2018

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË BRENDSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme, në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatit nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit qendror ose i varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës, sipas objektit të kërkesëpadisë, nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas këtij



urdhri, i jep të drejtë, përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjyqimit, si dhe të drejtën për të hartuar, dorëzuar dhe nënshkruar kërkesëpadi.

6. Përfaqësuesit e autorizuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Brendshme.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ky është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë të Ministrisë së Brendshme, qendrore dhe vendore, të caktojnë një person përgjegjës, si pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

9. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i

Përgjithshëm, deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 1044, datë 18.10.2017, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme”, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

10. Ngarkohen institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, drejtoria që mbulon çështjet gjyqësore për aparatin dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet sektori i arkiv protokollit për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të varësisë së Ministrisë së Brendshme.

12. Urdhri nr. 1044, datë 18.10.2017, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme”, si dhe çdo dispozitë e përcaktuar në urdhra të tjerë që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN CIVILE ME PALË:

Paditës:

E paditur:

Objekti:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, dhe të urdhrat të Ministrit të Brendshëm nr., datë, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme”;

VENDOSA:

Autorizimin e Z/Znj., me detyrë, për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Brendshme, në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor/në Gjykatën e Apelit/në Gjykatën e Lartë.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT)

**KËRKESË**

Shtetasi Leonard Lashi, i biri i Pandeliut dhe i Kalies, i datëlindjes 27.7.1976, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të vdekur të vëllait të tij, shtetasit Thoma Lashi, i datëlindjes 19.5.1966.

KËRKUES
Leonard Lashi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë